



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKANDËR MOISIU" Durrës  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1323/17 Prot.

Durrës, më 19.05.2025

**VENDIM**

Nr. 65, datë 19.05.2025

**PËR**

**"MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN E PROGRAMIT TË  
STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË, BACHELOR NË "GAZETARI DHE  
MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN", DEPARTAMENTI I SHKENCAVE POLITIKE,  
FAKULTETI I SHKENCAVE POLITIKE JURIDIKE"**

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr. 41 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar me VKM Nr.879, datë 16.12.2019 "Disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" në Udhëzimin Nr.1, datë 14.01.2020, "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar; në Statutin dhe në Rregulloren e UAMD-së, në shkresën e Dekanit të FSHPJ me Nr. 1171 prot., datë 24.04.2025, si dhe në relacionin e Drejtorisë Juridike me Nr. 1171/1 prot., datë 12.05.2025, në mbledhjen e datës 19.05.2025, Senati Akademik,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e ndryshimeve në rregulloren e programit të studimit të ciklit të parë, Bachelor në "Gazetari dhe Marrëdhënie me Publikun", të Departamentit të Shkencave Politike në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
  - Zv. Rektorët
  - Drejtuesi i Njesisë Kryesore i FSHPJ
  - Drejtuesi i Njesisë Bazë i Departamentit të Shkencave Politike
  - Drejtoria e Kurrikulave, Cilësisë dhe Statistikave
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi**

